



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:123513
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05734574

C.nr.1662/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Durim Balaj dhe me bashkëpunëtorin profesional Senad Lokaj, në çështjen kontestimore të paditësve I.A, nga fshati ... Komuna e Gjakovës, si dhe E.O., dhe E.V., që të dy nga Gjakova, të cilin e përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson e autorizuar Vlora Rrahmani, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, në të cilin prezantuan të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, më 24 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.A., nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë, respektivisht për 776 ditë pune, dhe atë për periudhën nga data 16.06.2019 e deri me datë 21.11.2022, t'ia paguajë shumën prej 1,552.00 euro, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 16.06.2022 (data e paraqitjes se padisë), e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.O., nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë, respektivisht për 458 ditë pune, dhe atë për periudhën nga data 16.06.2019 e deri me datë 31.08.2021, t'ia paguajë shumën prej 916.00 euro, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 16.06.2022 (data e paraqitjes se padisë), e deri

në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

III. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.V., nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë, respektivisht për 598 ditë pune, dhe atë për periudhën nga data 16.06.2019 e deri me datë 21.11.2022, t'ia paguajë shumën prej 1,196.00 euro, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 16.06.2022 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës që paditësve, në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ua paguaj shumën prej 726.40 euro, në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësit, fillimisht kishin iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamentin për Çështje Administrative, me datë 16.06.2022, përmes të autorizuarit të tyre, ku kishin theksuar se sipas Kontratave Kolektive Sektoriale të Arsimit në Kosovë, është paraparë kompensimi për ushqim gjatë punës si dhe shpërblimi jubilar, për të gjithë punonjësit që kanë marrëdhënie të punës në institucionet arsimore, mirëpo paditësve nuk i janë kompensuar nga e paditura kompensimet në fjalë.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1508/2022 të datës 27.03.2024, pas plotfuqishmërisë, lënda në fjalë i është deleguar Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm.

I autorizuari i paditësve, me parashtrësën e datës 16.04.2023, ka bërë precizimin e kërkesëpadiës, ashtu që kanë rregulluar padinë në aspektin subjektiv dhe objektiv, ku fillimisht paditësi A.G., e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa tutje si palë ndërgjyqëse kanë mbetur paditësit I.A., E.O., dhe E.V., e po ashtu kanë parashtruar se tani paditësit kërkojnë kompensim vetëm për ushqim, e jo edhe shpërblimin jubilar. Andaj, ka kërkuar që të detyrohet e paditura që për paditësin I.A., në emër

të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga data 16.06.2019-21.11.2022, t'i paguhet shuma prej 1,552.00 euro, për paditësen E.O., në emër të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga data 16.06.2019-31.08.2021, t'i paguhet shuma prej 916.00 euro, ndërsa për paditësin E.V., në emër të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga data 16.06.2019-21.11.2022, t'i paguhet shuma prej 1,196.00 euro.

I autorizuari i paditësve gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara paditësit i kanë vërtetuar të gjitha pretendimet e tyre për çka gjykatës i propozojmë që kërkesëpadinë e paditësve të aprovoj si të bazuar dhe ashtu sipas parashtrësën e datës 16.04.2024.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: taksën gjyqësore për padi shumën prej 41.00 euro, përpilimin e padisë 208.00 euro, përpilimin e parashtrësës 208.00 euro, si dhe përfaqësimin në seancë 270.40 euro, e në tërësi shumën totale prej 727.40 euro.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, me datën 06.02.2024, ka parashtruar përgjigje në padi, ku ka theksuar se sipas kontratës së punës askund nuk ceket se punëtorët e gëzojnë të drejtat të cilat ata i pretendojnë, të cilën kontratë paditësit e kanë nënshkruar dhe janë pajtuar me të gjitha kushtet e kontratës si dhe për detyrat dhe obligimet që kanë, ashtu që kërkesës së paditësve u mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim. Andaj, ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

E autorizuarja e të paditurës gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke theksuar se sa i përket bazës juridike për nxjerrjen e aktit administrativ në bazë heshtjen administrative siç u deklarua nga i autorizuari i paditësve kjo çështje veç është zgjidhur sa i përket kompetencës, nga ana tjetër e kundërshton parashtrësën e pranuar sot në këtë seancë sa i përket kërkesës për kompensimin e ushqimit për paditësit I.A., E.O., dhe E.V., ndërsa pajtohem me tërheqjen e kërkesëpadisë sa i përket shpërblimit jubilar dhe kompensimin e ushqimit lidhur me paditësin A.G., e po ashtu pajtohem me tërheqjen e padisë në raport me pjesën e parashkruar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: Vendimi i lëshuar nga e paditura Komuna e Gjakovës me nr. 01 Nr.112/02-11919 dt. 30.04.2018; Akt emërimi me nr. 03 nr.112/01-37799 datës 08.10.2019; Vendimi i lëshuar nga e paditura Komuna e Gjakovës me nr. 01 nr.112/02-24087 dt. 06.12.2017; Vendimi i lëshuar nga e paditura Komuna e Gjakovës me nr. 01 nr.112/02-5216 dt. 04.03.2022; Vërtetimi për ditët e prezencës në punë me nr. protokolli nr. prot.165/2024 datës 15.04.2024; Vërtetimi për ditët e prezencës në punë me nr. protokolli nr. prot.496/2024 datës 11.04.2024; Vërtetimi për ditët e prezencës në punë me nr. protokolli nr. prot.01/443 datës 11.04.2024.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara, është vërtetuar gjendja faktike si në vijim:

Nga Vendimi i lëshuar nga e paditura Komuna e Gjakovës me nr. 01 Nr.112/02-11919 dt. 30.04.2018, gjykata ka vërtetuar se Kryetari i Komunës së Gjakovës, e ka zgjedhur tani paditësin E.V., zëvendës drejtor në Shkollën “...” në Gjakovë, për një periudhë 4 vjeçare, dhe atë nga data 30.04.2018 deri me datën 30.04.2022.

Nga Akt emërimi me nr. 03 nr.112/01-37799 datës 08.10.2019, gjykata ka vërtetuar se paditësja E.O., është emëruar zëvendës drejtoreshë e Shkollës “...” në Gjakovë në kohëzgjatje prej 4 vitesh.

Nga vendimi i lëshuar nga e paditura Komuna e Gjakovës me nr. 01 nr.112/02-24087 dt. 06.12.2017, gjykata ka vërtetuar se tani paditësi I.A., është zgjedhur drejtor në Shkollën “...” në fshatin....., Komuna e Gjakovës, në kohëzgjatje prej 4 vitesh.

Nga vendimi i lëshuar nga e paditura Komuna e Gjakovës me nr. 01 nr.112/02-5216 dt. 04.03.2022, gjykata ka vërtetuar se tani paditësi I.A., është caktuar ushtrues detyre i drejtorit të shkollës “....” në

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë me nr. protokolli nr. prot.165/2024 datës 15.04.2024, gjykata ka vërtetuar se paditësi I.A., për periudhën kohore nga data 16.06.2019-21.11.2022, ka punuar gjithsej 776 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë me nr. protokolli nr. prot.496/2024 datës 11.04.2024, gjykata ka vërtetuar se paditësi E.V., për periudhën kohore nga data 16.06.2019-21.11.2022, ka punuar gjithsej 598 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë me nr. protokolli nr. prot.01/443 datës 11.04.2024, gjykata ka vërtetuar se paditësja E.O., për periudhën kohore nga data 16.06.2019-31.08.2021, ka punuar gjithsej 458 ditë pune.

Gjykata vendosi në raport me kërkesën e paditësit e cila ka të bëjë me kompensimin e shujtave ditore, duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 si dhe kontratën e datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin”,* e duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk ka argumentuar (me asnjë provë materiale, faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve (në vend punimin – objektin ku kanë punuar këtu paditësit), si dhe duke pasur parasysh faktin se Kontratat e elaboruara më sipër, është vërtetuar fakti se paditësit janë dhe kanë qenë në marrëdhënie pune me të paditurën, ndërsa vërtetimet mbi ditët e prezencës në punë për paditësit e lartcekur, të lëshuar nga shkolla përkatëse në të cilat janë specifikuar saktë ditët e prezencës në punë të paditësve, gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e paditësve për një kompensim të këtillë është e themelte, andaj edhe iu aprovua sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L–077) është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta*

përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 paragrafi 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësit, t’ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë të aprovuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shujta, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa, sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësit.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës, mirëpo i njëjti pretendim ishte i pabazuar, ngase për kërkesat e parashtruara nga paditëset parashihet afat tre (3) vjeçar sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, ndërsa shikuar precizimin e kërkesëpadisë dhe dispozitën ligjore të lartcekur, gjykata erdhi në përfundim se nuk kemi të bëjmë në këtë rast me parashkrim të kërkesës.

Gjykata me aktvendimin e datës 20.05.2024, e ka konstatuar të tërhequr padinë e paditësit Arsim Gala kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, e po ashtu e ka konstatuar të tërhequr padinë e paditësve I.A., E.O dhe E.V. në raport me shpërblimin jubilar si dhe për kompensimin e shujtave ditore për periudhën 18.04.201 deri më 15.06.2019, meqenëse i autorizuari i paditësit është tërhequr nga këto kërkesa, për këto arsye gjykata ka vendosur që ta konstatoj të tërhequr padinë për këtë pjesë, duke u bazuar në nenin 261 paragrafi 2 të LPK-së.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendosja lidhur me shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 452 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ashtu që paditësve iu njohën shpenzimet në shumën prej 726.40 euro, shpenzime këto të cilat iu referohen shpenzimeve si në vijim: për përpilimin e padisë shumën prej 208.00 euro, për përpilimi i parashtresës për precizimin e kërkesëpadisë 208.00 euro, për përfaqësim në një seancë gjyqësore shumën prej 270.40 euro, si dhe për taksë gjyqësore për padi, shumën prej 40.00 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1662/23, me 24 maj 2024

GJYQTARI

Durim BALAJ

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.